



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.14, datë 05.02.2021

**PËR
RIALOKIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA NË FORMËN E TRANSFERTËS SË
PAKUSHTËZUAR NGA FONDI I RINDËRTIMIT I BUXHETIT TË SHTETIT ME
VLERË 1,241,641,916 LEKË TË PASHPENZUARA NË VITIN 2020, QË DO TË
TRASHËGOHEN NË VITIN 2021**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM-së nr.644, datë 03.08.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve, që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore në bashkitë Lezhë dhe Durrës”, VKM-së nr. 540, datë 8.7.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale, të njëjësive të banimit në ndërtesa (pallat) si dhe mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Durrës, Tiranë, Lezhë, Krujë dhe Kavajë”, VKM-së nr.731, datë 16.09.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit në bashkitë Kurbin, Lezhë dhe Durrës”, VKM-së nr. 732, datë 16.9.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale, të njëjësive të banimit në ndërtesa (pallat), si dhe mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Krujë, Shijak, Durrës dhe Tiranë”, VKM-së nr.775, datë 30.09.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit nga bashkia Durrës, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projektpreventivit dhe rforcimin e hidrovorit të Durrësit”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.46, datë 24.12.2020 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020”,

Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të Buxhetit”, të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”, Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore” si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK V E N D O S I :

1. Miratimin e rialokimit të fondeve të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar nga fondi i rindërtimit i buxhetit të shtetit me vlerë 1,241,641,916 lekë të pashpenzuara për vitin 2020, që do të trashëgohen në vitin 2021, si më poshtë vijon:

Nr.	VKM që ka miratuar fondin	Emërtimi i fondit	Programi	Kap.	Llog. ekon.	Kodi i produktit	Fondi në lekë
1	Nr.540, Datë 08.07.2020	Rikonstruksioni ose riparimi i mjediseve në bashkëpronësi	04960		231	94902AB	708,461,900
2	Nr.644, Date 03.08.2020	Hartim projekti të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse	04960	1	230	94902AI	281,075,016
3	Nr.775, Datë 30.09.2020	Hartimi i projektpreventivit dhe rirforcimi i hidrovorit të Durrësit	04960	1	230	94902AI	51,550,000
4	Nr.731, Datë 16.09.2020	Proçesi i transportit të materialeve nga shembja e objekteve të dëmtuara nga tërmeti	04960	1	602	94902AH	76,455,000
5	Nr.732 Datë 16.09.2020	Rikonstruksion i banesave individuale të njëjësive të banimit në ndërtesa (pallat) DS 1,2,3	04960	1	604	94902AB	124,100,000
		Totali Kapitulli 1					1.241.641.916

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 05.02.2021





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 107 prot.

Durrës, më 08.02.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 14 datë 04.02.2021 “Për rialokimin e fondeve të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar nga fondi i rindërtimit i buxhetit të shtetit me vlerë 1,241,641,916 lekë të pashpenzuara në vitin 2020, që do të trashëgohen në vitin 2021”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

